



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr.251/2025

Datë: 29.09.2025

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrtari i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 64, paragrafi 1, nënparagrafi, 1.5, nenin 68, paragrafi, 1, nenin 69, nenin 71, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe 1.6, neni 92, paragrafi 1, nënparagrafin 1.1, neni 91, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe 1.9, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenin 13 (paragrafi 3, nënparagrafi 3.1) të Rregullores Nr. 04/2022 për Procedurën e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të ankesës me numër të protokollit 474 të dt. 06.05.2025, të parashtruar nga subjekti i të dhënave A.A, ndaj kontrolluesit Portalit “Sinjali”, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** si e bazuar, ankesa me nr. prot. 474, e datës 06.06.2025, e parashtruar nga z. A.A, ndaj Portalit “Sinjali” Sh.P.K, për shkak të publikimit të të dhënave personale, emrit dhe mbiemrit pa bazë ligjore, në artikullin me titull “XXXXXXXXX” më datë 25.05.2025.
2. **Shqiptohet** gjobë në vlerë prej **20,000.00 € (njëzetmijë euro)**, ndaj Portalit “Sinjali” Sh.P.K, në cilësinë e kontrolluesit, me adresë, Rr. “Luan Haradinaj” 110/2, Prishtinë, për shkak të publikimit të të dhënave personale pa bazë ligjore.
3. **Urdhërohet** Portali “Sinjali”, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave, që të anonimizojë të dhënat personale të subjekteve të të dhënave, konkretisht emrat dhe mbiemrat në artikullin e lartpërmendur në linkun: xxxxxxxx
4. **Obligohet** kontrolluesi, që shumën e përcaktuar nga pika 2 e këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 30 ditësh, në xhironlogarinë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi Nr. 1000400070005127/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
5. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Përmbartuesi Privat.

6. **Obligohet** kontrolluesi, që brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të njoftojë Agjencinë me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e pranimit.

A r s y e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia) ka pranuar një ankesë, më datë 06.06.2025, nga subjektin e të dhënave, e cila mbanë numrin e prot. 474, në të cilën shpreh shqetësimin se Portali “Sinjali” ka publikuar emrin dhe mbiemrin, moshën, vendit të tij, të prindit (babait) dhe të vëllait, në artikullin e titulluar “XXXXXXXXXX”. Sipas ankuesit, publikimi është bërë pa bazë ligjore duke shkelur të drejtën e tyre për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Ankuesi ka bashkangjitur si dëshmi edhe linkun në të cilin është bërë publikimi.

Bazuar në nenin 68 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), Agjencia, ka filluar procedurën e shqyrtimit të ankesës për të vërtetuar pretendimet e palës ankuese. Si fillim, zyrtari i inspektimit ka hulumtuar në linkun e bashkangjitur për të vërtetuar pretendimet e tij. Me këtë rast, pas hulumtimit të bërë në këtë link, është konstatuar se Portali “Sinjali” në artikullin me titull “xxxxxxxxxx”, ka publikuar emrin, mbiemrin, moshën dhe vendit të tij, të prindit (babait) dhe të vëllait.

Tutje, zyrtari i inspektimit më datë 06.05.2025, përmes postës elektronike (e-mail), i’u është drejtuar kontrolluesit, duke e njoftuar lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti i të dhënave dhe njëherë ka kërkuar që të njoftoj Agjencinë se cila është bazë ligjore, i publikimit të emrit dhe mbiemrit të subjektit të të dhënave dhe familjarëve të tij.

Me këtë rast, për arsye se Portali “Sinjali” nuk është përgjigjur në kërkesën e Agjencisë, zyrtari i inspektimit më datë 08.07.2025 ka ridërguar edhe njëherë kërkesën e Agjencisë në të cilën i është dhënë afat prej 15 ditë kontrolluesit, për tu përgjigjur në kërkesën e Agjencisë.

Edhe përkundër re-kërkesës nga Agjencia, kontrolluesit nuk është përgjigjur, duke mos ofruar asnjë justifikim për përpunimin e të dhënave personale, andaj Agjencia ka vazhduar shqyrtimin e ankesës.

LMDhP në nenin 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, ka dhënë përkufizimi i shprehjes ‘kontrollues i të dhënave’ me të cilin nënkuptohet se kontrollues i të dhënave është çdo person fizik apo juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale. Andaj, sipas këtij përkufizimi, Portali “Sinjali” në këtë rast cilësohet kontrollues i të dhënave.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Agjencia ka konstatuar se ankuesi, babai dhe vëllai i tij konsiderohen persona të zakonshëm (jo figura publike) sipas artikullit të publikuar, dhe si të tillë gëzojnë një nivel më të lartë të mbrojtjes së privatësisë. Publikimi i emrave dhe mbiemrave të tyre për një ngjarje familjare, siç është dhuna në familje, nuk plotëson kriteret e interesit publik, i cili mund të përkufizohet si kontribut në një debat me rëndësi shoqërore. Bazuar në një peshim të mbrojtjes së të dhënave personale kundrejt të drejtës për lirinë e shprehjes, publikimi i artikullit nga Portali “Sinjali” mund të ketë pasur qëllim informimin e publikut për një ngjarje aktuale, e cila mund të konsiderohet si interes publik për të rritur ndërgjegjësimin

për çështje të dhunës në familje. Megjithatë, publikimi i emrit dhe mbiemrit të viktimës (ankuesit) familjarëve të tij, duke i bërë ata të identifikueshëm, ka cenuar dinjitetin dhe të drejtën e tyre për privatësi, veçanërisht nëse ata janë qytetarë të zakonshëm dhe konteksti i publikimit mund të ketë pasojë negative për jetën e tyre private, familjare dhe sociale, pa qenë proporcional me qëllimin e informimit publik. Identifikimi i individëve në një kontekst kaq sensitiv, si dhuna në familje, nuk është i nevojshëm për të përmbushur qëllimin në kuptimin e ndërgjegjësimit shoqëror dhe promovimit të diskutimit publik mbi këtë problematikë.

Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. LMDhP, në nenin 3, paragrafin 1.1 ka përcaktuar se me të dhëna personale nënkuptojmë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”) një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

LMDhP në neni 4, ka paraparë parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale, e një nga parimet e para të përpunimit është parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës ku sipas të cilit, të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Pra, si parim shumë i rëndësishëm është ligjshmëria e përpunimit, por kjo nuk nënkupton se parimet tjera kanë më pak rëndësi por vetëm se me rastin e përpunimit të të dhënave personale si fillim duhet të shikuar ligjshmëria e përpunimit pastaj pasojnë parimet tjera me radhë siç janë: parimi i kufizimit të qëllimit, parimi i minimizimit të të dhënave, parimi i kufizimit të ruajtjes së të dhënave si dhe parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit.

Sipas nenit 3, paragrafit 1, nën paragrafit 1.2 të LMDhP-së, përpunim i të dhënave është çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Siç mund të kuptohet nga ky përkufizim edhe publikimi i të dhënave (emri, mbiemri, mosha dhe vendi), konsiderohet përpunim i të dhënave personale, dhe si i tillë duhet të bëhet në mënyrë të ligjshme.

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet së paku një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDhP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në harmoni me ligjin. Sipas nenit 5, paragrafi 1 të LMDhP-së, përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm vetëm nëse zbatohet, të paktën njëri nga kriteret si në vijim: 1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike; 1.2. nëse përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen e një kontrate, në të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese ose për të ndërmarrë veprimet lidhur me kërkesën e subjektit të të dhënave para lidhjes së kontratës; 1.3. nëse përpunimi është i domosdoshëm

për respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi; 1.4. nëse përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose personave të tjerë fizikë; 1.5. nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose për ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë kontrolluesit; 1.6. nëse përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë, përveç kur këto interesa tejkalohen nga interesat apo të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave që kërkon mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave është fëmijë.

Kushtetuta e Kosovës si akti më i lartë juridik, në nenin 40, ka garantuar lirinë e shprehjes, sipas të cilës, liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.

Liria e shprehjes si e drejtë e garantuar me Kushtetutë duhet të balancohet me të drejtat të tjera kushtetuese dhe ligjore që janë gjithashtu të rëndësishme në një shtet demokratik, siç është e drejta për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Në praktikën evropiane është theksuar se mediat, kur raportojnë për çështje private, duhet të balancojnë të drejtën për informim publik (neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) me të drejtën për privatësi (neni 8 i KEDNJ) (<https://rm.coe.int/eng-guidelines-on-safeguarding-privacy-in-the-media/1680a012c7>
<https://ico.org.uk/media2/migrated/4025760/data-protection-and-journalism-code-202307.pdf>).

LMDhP përfshinë rregulla specifike që ndihmojnë në balancimin e së drejtës për privatësi me të drejtën e lirisë së shprehjes, pasi që asnjë nga këto dy të drejta nuk është më e rëndësishme se tjetra. Në këndvështrim të kësaj, përpunimi i të dhënave personale për interes publik duhet të ndjekë një qëllim legjitim me mjete të arsyeshme dhe të jetë proporcional me qëllimin e kërkuar dhe se duhet të arrihet ekuilibër midis kërkesave të publikut dhe kërkesave për mbrojtjen e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Gjatë publikimit të të dhënave personale, është me rëndësi të respektohet **parimi i minimizimit** të të dhënave personale, që është një nga parimet e mbrojtjes së të dhënave. Parimi i minimizimit të të dhënave kërkon që përpunimi i të dhënave personale të kufizohet në atë që është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e publikimit.

Në kuadër të lirisë së shprehjes dhe informimit të publikut, artikulli mund të publikohej pa përfshirë të dhëna personale (si emrin dhe mbiemrin) që identifikojnë drejtpërdrejt subjektin e të dhënave, duke ruajtur të njëjtin qëllim dhe rëndësi të publikimit. Një publikim i tillë, i cili është i qasshëm për një numër të pakufizuar vizitorësh në internet, do të shmangte dëmin e panevojshëm ndaj subjekteve të të dhënave, pasi që natyra e informacionit ka të bëjë me një incident brenda familjes, pra ngjarje që drejtpërdrejtë prekë jetën private dhe familjare.

Publiku ka interes të njoftohet për fenomenin e dhunës në familje, por jo edhe për identitetin e individëve konkret, përveç nëse ata janë figura publike. Publikimi i emrave në këtë rast nuk shton vlerën e informimit të publikut. Kontrolluesi do të kishte mundur të raportonte ngjarjen duke ruajtur identitetin e personave dhe në artikullin e publikuar të mos përdorte emrat e personave të përfshirë në ngjarje, përfshirë edhe viktimën.

Publikimi i emrave dhe mbiemrave në këtë kontekst krijon stigmatizim, dëmton reputacionin dhe mund të ketë pasoja sociale dhe psikologjike për palët.

Andaj, duke u mbështetur në ankesën e parashtruar, analizën e fakteve dhe përmbajtjen e artikullit të publikuar në portalin “Sinjali” me titull “xxxxxxxxxxxx”, Agjencia konstaton se kontrolluesi ka përpunuar të dhëna personale në kundërshtim me dispozitat ligjore. Konkretisht, duke publikuar emrin dhe mbiemrin e subjektit të të dhënave pa justifikuar interesin publik, kontrolluesi ka shkelur nenin 4 paragrafët 1 dhe 3 si dhe nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Agjencia për përcaktimin e vlerës së gjobës kundërvajtëse, ka zbatuar kriteret e përcaktuara në nenin 91, paragrafi 1 të LMDhP. Në veçanti, janë vlerësuar natyra dhe rëndësia e shkeljes, kategoria e të dhënave personale të përfshira, si dhe karakteri i qëllimshëm dhe i përsëritur i shkeljes. Kontrolluesi është njoftuar paraprakisht për paligjshmërinë e veprimeve të kryera, ndërsa masa të ngjashme korigjuese janë urdhëruar më herët për të njëjtën çështje, çka dëshmon mospërfillje të vazhdueshme të detyrimeve ligjore.

Agjencia konsideron se gjoba kundërvajtëse e vendosur është efektive, që do të thotë se do të arrijë qëllimin për të ndëshkuar kontrolluesin për një shkelje të tillë, dhe si e tillë është proporcionale me shkeljen dhe është bindëse me qëllim që kontrolluesi në të ardhmen t'i shmanget sanksioneve të tilla, e rrjedhimisht të përpunojë të dhëna personale në pajtim me ligjin. Objektivi bazë i LMDhP-së është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë, në veçanti të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas inspektimit të kryer dhe vërtetimit të gjendjes faktike, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 29.09.2025]

Zyrtare për Inspektim

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Portalit “Sinjali” Sh.P.K, kontrollues,
- Palës ankuese,
- Arkivit të Agjencisë.